



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:053997  
Datë: 15.07.2024  
Numri i dokumentit: 05939660

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Mirjeta Shala dhe me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve SH. SH. dhe SH. C., që të dy nga Gjakova, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar Qëndresa Bytyqi Hoxha, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 3,206.56 euro, jashtë seance me datë 15 korrik 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve SH. SH. dhe SH. C., që të dy nga Gjakova, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëseve të lartcekur të iu paguajë :

- Paditëses SH. SH. nga Gjakova, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për periudhën kohore nga data 01.01.2020 e deri me datë 30.11.2022, shumën prej 738.79.- € (shtatëqind e tridhjetë e tetë euro e shtatëdhjetë e nëntë cent);
- Paditësit SH. C. nga Gjakova, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për periudhën kohore nga data 01.01.2020 e deri me datë 30.11.2022, shumën prej 738.79.- € (shtatëqind e tridhjetë e tetë euro e shtatëdhjetë e nëntë cent);

Të gjitha shumat e lartcekura, detyrohet e paditura që të i paguajë me kamatë ligjore prej 8% në vit për secilën paditëse, e cila do të llogaritet nga data 15.02.2023 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve SH. SH. dhe SH. C., që të dy nga Gjakova, mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumat e kërkuara dhe atë në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për paditësen SH. SH. në shumën prej 864.49.-€ dhe për paditësin SH. C. në shumën prej 864.49.-€.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve të iu paguajë shumën prej 332.00.-€ (treqind e tridhjetë e dy euro) në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Paditësit SH. SH. dhe SH. C., që të dy nga Gjakova, në këtë gjykatë me datë 15.02.2023, përmes të autorizuarit të tyre Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditëset janë në marrëdhënie pune me të paditurën, të sistemuar pranë shkollës “Zekeria Rexha”. Në bazë të nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditësve. Meqë e paditura nuk e ka përmbushur këtë detyrim, paditësit kanë paraqitur padi përmes të cilës kanë kërkuar që të iu kompensohet diferenca e inflacionit në pagë, me kamatë ligjore si dhe i kanë kërkuar edhe shpenzimet procedurale.

I autorizuari i paditësve përmes parashtrësve të dorëzuara në gjykatë me datë 12.06.2024 ka kërkuar nga gjykata që ta detyroi të paditurën që në emër të kompensimit të diferencës së inflacionit në pagë për paditësen SH. SH. për periudhën nga data 01.01.2020 deri me datë 30.11.2022, të ia paguajë shumën prej nga 1,603.28 euro dhe për paditësin SH. C. për periudhën nga data 01.01.2020 deri me datë 30.11.2022, paditësit të ia paguajë shumën prej nga 1,603.28 euro, për të dyja ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj Qëndresa Bytyqi Hoxha, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 05.04.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se ky kompensim paditësve nuk iu takon as me kontratën e punës, e gjithashtu as me Ligjin e Punës. Sa i përket Kontratës Kolektive ka konsideruar se e njëjta është në kundërshtim me Ligjin e Punës, pasi që Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve. Ka konsideruar se në rastin konkret ka po ashtu parashkrim të kërkesës në të holla, si dhe ka theksuar se ka indikacione që kemi të bëjmë me rast të gjykuar, ku ka kërkuar nga gjykata verifikimin e kësaj rrethane. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nuk janë kontestuese faktet si në vijim :

Për paditësen SH. SH., gjykata gjeti se e njëjta është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në shkollën “Zekeria Rexha” në Gjakovë, si mësimdhënëse e gjuhës shqipe dhe paga bazë e saj është në lartësi prej 421.00 euro, fakt i vërtetuar përmes listave të pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhën 2020-2022.

Për paditësin SH. C., gjykata gjeti se e njëjta është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në shkollën “Zekeria Rexha” në Gjakovë, si mësimdhënësi i mësimit klasor dhe paga bazë e tij është në lartësi prej 421.00 euro, fakt i vërtetuar përmes listave të pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhën 2020-2022.

Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.3%, për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve iu takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga listat e pagave që gjenden në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjen zingjirore të inflacionit ndër vite duke filluar llogaritjen nga viti 2020 deri në vitin 2021 (brenda kërkesës së paditësve) sipas përlllogaritjes si në vijim :

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditësve e cila në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për

periudhën 12 mujore në total të jetë 10.10 euro, apo 0.84 euro për muaj ( $421 \cdot 0.2\% \cdot 12 = 10.10$ )

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.40%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësve sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2021 do të duhej të ishte 421.84 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 172.11 euro, apo 14.34 euro për muaj ( $421.84 \cdot 3.40\% \cdot 12 = 172.11$ ).
- Për periudhën Janar-Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësve sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2022 do të duhej të ishte 436.18 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 556.57 euro, apo 50.60 euro për muaj ( $436.18 \cdot 11.6\% \cdot 11 = 556.57$ ).

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditëset janë të punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data 01.01.2020 deri me datë 30.11.2021 në pagën e paditësve nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Fillimisht, sa i përket pretendimit të të paditurës se rasti ka të bëjë me çështje të gjykuar, gjykata gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar kjo për faktin se pas shikimit të të gjitha çështjeve juridike kontestimore të iniciuara nga paditësi lidhur me kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e inflacionit, ka rezultuar se në këtë gjykatë për periudhën e kërkuar sipas padisë së datës 15.02.2023, konkretisht nga 01.01.2020 deri me datë 30.11.2022, nuk përfshin periudhën e gjykuar me aktgjykimin, andaj nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim i tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësve dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësit.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës, gjykata vë në dukje se i autorizuari i paditëseve me parashtrësën e datës 25.03.2024 ka bërë precizimin e padisë, ndërsa pretendimi se kërkesa është e parashkruar në tërësi rezulton i pabazuar sa i përket periudhës prej datës 01.01.2020 e deri me datë 30.11.2022 pasi që konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 15.02.2023, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumës së përgjithshme prej në lartësi prej 1,728.98 euro (për paditësen SH. SH. në shumë prej 864.49 euro, ndërsa për paditësin SH. C. shumë prej 864.49euro), gjykata të njëjtën e refuzoi për shkak se paditësit as me padi, as në precizimin e padisë nuk kanë prezantuar prova materiale për të vërtetuar këtë lartësi të kërkesës, sipas detyrimit të përcaktuar me nenin 7 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. E për më tepër, gjykata përllogaritjen e përfshirjes së inflacionit në pagën bazë e ka filluar nga viti 2020, duke shtuar normën e inflacionit vit për vit deri në vitin 2022 (*shtimi dinarik*), për çka rezultoi se pjesa e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar është e pabazuar, andaj gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit, gjykata e morri sipas nenit 449 dhe 452 par.2 të LPK-së, me ç’rast paditësve iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 332.00.-€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€ (të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 156.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17)si dhe shuma prej 156.00 -€ për parashtrësën mbi precizimin e kërkesëpadisë. Ndërsa paditësve nuk iu pranua pjesa tjetër e shpenzimeve të kërkuara dhe atë në emër të taksës gjyqësore shumë prej 1.00 euro, për shkak se nuk kanë ofruar prova për këtë shpenzim.

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË  
Departamenti i Përgjithshëm  
2023:053997, datë 15 korrik 2024

Gj y q t a r j a,  
Mirjeta Shala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.